



Prishtinë, 29 maj 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3251_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084); Nenin 8 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085); Nenin 12, Nenin 14 dhe 17 të Ligjit për Energjinë (Nr. 05/L-081); Nenin 50 të Ligjit për Promovimin e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (Nr. 08/L-258), Nenin 4, Nenin 5, Neni 6, Nenin 7, Nenin 8, Neni 11, Neni 12, Nenin 13, Neni 16, Neni 17, Neni 18, Neni 19 par. 1 dhe Neni 20 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë; Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Lladroc, Komuna e Malishevës, të datës 20.04.2026 të shoqërisë "SUNNEX ENERGY" L.L.C., me adresë: Rruga „Venet Bajrami“ pn, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës, dhe Vendimet, lejet dhe pëlqimet e lëshuara nga institucionet përgjegjëse, si në Shtojcën II. të këtij vendimi,

në seancën e mbajtur më 29 maj 2026 nxori këtë:

V E N D I M PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT

- I. **APROVOHET - dhe i lëshohet AUTORIZIMI** shoqërisë "SUNNEX ENERGY" L.L.C., me Numër Unik Identifikues (NUI) 812113330 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **3 MW**, në ngastrën kadastrale: nr. 1959-9 dhe 1959-15 ZK Lladroc, sipas Leje Ndërtimore Numri i vrojtimit të lejes: Nr.05/304 dt. 12.09.2025, për "Ndërtimi i parkut të energjisë diellore me kapacitet 3 MW, ngastra kadastrale nr. 1959-9 dhe 1959-15 ZK Lladroc, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Malishevës, dhe Vendimin për Pëlqimin Mjedisor Nr.5409-2/24 dt. 10.12.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- II. **OBLIGOHET** - shoqëria "SUNNEX ENERGY" L.L.C., që brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të këtij Vendimi, që të dorëzoj garancionin financiar në vlerë prej 8% të vlerës së projektit, të lëshuar nga një Bankë Komerciale e licencuar apo kompani e sigurimeve, me vlefshmëri që mbulon periudhën njëzetekatër (24) mujore sipas Planin Dinamik të Realizimit të dorëzuar nga Aplikuesi.
- III. Garancioni financiar sipas pikës II. të këtij Vendimi, do të jetë në vlerën prej 69,600.00 € (gjashtëdhjetë e nëntëmijë e gjashtëqind Euro), sipas vlerës së projektit të prezantuar me Planin e Biznesit, dhe në rast se nuk dorëzohet garancioni financiar në ZRRE brenda afatit ligjor sipas dispozitivit nën pikën II. të këtij Vendimi, **ky Vendim për Autorizim do të ndërpritet dhe njëkohësisht do të shfuqizohet.**



- IV. Autorizimi sipas dispozitivit nën pikën I. të këtij Vendimi, i lëshohet shoqërisë “SUNNEX ENERGY” L.L.C., sipas Planit Dinamik të Realizimit, dhe obligohet që brenda kësaj periudhe të ndërtoj stabilimentet e reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike.
- V. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e lëshimit të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organi kompetent sipas Ligjit për Ndërtimin.
- VI. Leja Mjedisore e lëshuar nga MMPH për projektin Energjetik për Kapacitetet e reja Gjeneruese, do të jetë kusht për fillimin e operimit komercial.

Arsyetim

- ZRRE, më 20.04.2026 nga shoqëria “SUNNEX ENERGY” L.L.C., ka pranuar aplikacionin për marrjen e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **3 MW**, sipas VENDIMIT PËR LEJE NDËRTIMORE të Komunës së Malishevës, Republika e Kosovës.
- ZRRE me datë 14.05.2026, Njoftimin Publik e ka publikuar edhe në faqen zyrtare të ZRRE-së, në pajtim me Nenin 13 par. 4 të Rregullës në fuqi.
- Shoqëria “SUNNEX ENERGY” L.L.C., me datë 15.05.2026, ka bërë Njoftimin Publik në media të shkruara elektronike, ku ka njoftuar të gjitha palët e interesit se në pajtim me Nenin 8 të Rregullës së Autorizimit ka aplikuar në ZRRE, pas kompletimit të dokumentacionit për marrje të autorizimit, me të cilën palët e interesuara janë njoftuar se vërejtje të tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda tetë (8) ditësh nga data e publikimit.
- ZRRE, brenda këtij afati dhe deri në shqyrtimin e aplikacionit nga Bordi i ZRRE-në, nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo ankesë. Gjithashtu aplikuesi ka dorëzuar edhe pagesën e taksës së shqyrtimit të aplikacionit me datë 15.05.2026 në ZRRE.
- ZRRE, pas analizimit të dëshmive të sjellura sipas Aplikacionit për Autorizim dhe vlerësimit të tyre nga ana e ZRRE-së, ka konsideruar se aplikuesi “SUNNEX ENERGY” L.L.C., i ka plotësuar kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ato ligjore për tu trajtuar dhe pajisur me Autorizimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **3 MW**, në ngastrën kadastrale: nr. 1959-9 dhe 1959-15 ZK Lladroc, sipas Leje Ndërtimore Numri i vrojtimit të lejes: Nr.05/304 dt. 12.09.2025, për “Ndërtimi i parkut të energjisë diellore me kapacitet 3 MW, ngastra kadastrale nr. 1959-9 dhe 1959-15 ZK Lladroc, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Malishevës, Vendimin për Pëlqimin Mjedisor Nr.5409-2/24 dt. 10.12.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 4588 dt. 01.04.2026 të lëshuar nga KEDS SH.A., Dëshmi mbi të drejtat pronësore, Deklaratën për shitjen e energjisë, Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar, Planin e Biznesit, dhe Plani Dinamik i Realizimit për periudhën njëzetekatër (24) mujore.
- Projekti është në përputhshmëri me strategjinë e energjisë dhe dokumentacionet relevante për zhvillimin e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë.



- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të dëshmive të bashkangjitura dhe lejeve, pëlqimeve dhe vendimeve të lëshuara nga institucionet përgjegjëse, dhe dëshmive administrative, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.


VII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bashkëngjitur Vendimit janë Shtojca I dhe Shtojca II.


Bordi i ZRRE-së:




Ymer Fejzullahu, Kryesues



Lutfije Dervishi, Anëtare



Gani Buçaj, Anëtar



Arta Isufi, Anëtare



Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Malishevës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.



SHTOJCA I

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) duke ushtruar kompetencat e dhëna me Nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe në përputhje me Nenin 17 të Rregullës Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë, “SUNNEX ENERGY” L.L.C., me adresë: “Rr. „Venet Bajrami“ pn, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës, më 29 maj 2026, i lëshon këtë:

AUTORIZIM

1. Për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **3 MW**, në ngastrën kadastrale: nr. 1959-9 dhe 1959-15 ZK Lladroc, sipas Leje Ndërtimore Numri i vrojtimit të lejes: Nr.05/304 dt. 12.09.2025, për “Ndërtimi i parkut të energjisë diellore me kapacitet 3 MW, ngastra kadastrale nr. 1959-9 dhe 1959-15 ZK Lladroc, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Malishevës, dhe Vendimin për Pëlqimin Mjedisor Nr.5409-2/24 dt. 10.12.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
2. Me këtë Autorizim, autorizohet shoqëria “SUNNEX ENERGY” L.L.C., që të ndërtoj kapacitetet gjeneruese në lokacionin e caktuar më lart, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara Rregullën e Autorizimit.
3. Ky Autorizim lëshohet sipas Planit Dinamik të Realizimit duke filluar nga data e lëshimit të tij. ZRRE me kërkesë të palës mund ta vazhdoj vlefshmërinë e Autorizimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Pala e Autorizuar, gjatë tërë periudhës së vlefshmërisë së këtij Autorizimi, duhet të plotësojë:
 - 2.1. të gjitha kushtet e përcaktuara me këtë Autorizim, dhe
 - 2.2. të gjitha kushtet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe ato për mjedisin.
5. Në rast se pala e Autorizuar falimenton para se të ndërtohet stabilimenti gjenerues i autorizuar, atëherë ky Autorizim do të pezullohet dhe do të mbetet i tillë derisa ZRRE përcakton se janë arritur kushtet për tërheqjen e pezullimit. Derisa ky Autorizim është i pezulluar e tërë puna e mëtutjeshme në ndërtimin e stabilimentit gjenerues të autorizuar duhet të ndërpritet. Në rast të kundërt, ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
6. Vlefshmëria e këtij Autorizimi automatikisht do të përfundoj sipas Nenit 19 par. 1 të Rregullës Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve të energjisë, apo me skadimin e afatit shtesë të përcaktuara nga ZRRE.
7. Në rast se pala e Autorizuar bën shkeljen e ndonjërit prej kushteve të këtij Autorizimi dhe të dispozitave ligjore në fuqi, ZRRE do të pezulloj këtë Autorizim në përputhje me dispozitat e Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja. Nga data e pezullimit të Autorizimit e tërë puna e mëtutjeshme në stabilimentin e autorizuar do të ndërpritet. Në rast të mos respektimit të kushteve ligjore, ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara sipas legjislacionin në fuqi.



SHTOJCA II

Lista e dokumenteve (lejeve, pëlqimeve, vendimeve etj.) të lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës lidhur me marrjen e **Autorizimit për Ndërtim** të shoqërisë "SUNNEX ENERGY" L.L.C., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike – ZK Lladroc, me kapacitet të instaluar prej **3 MW**, Komuna e Malishevës, si në vijim:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.5409-2/24 dt. 10.12.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore Nr. 05/112 dt. 13.06.2025 e Lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Malishevës.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Nr.05/304 dt. 12.09.2025 dhe Numri i Vrojtimit të lejes: 05/304 për "Ndërtimi i parkut të energjisë diellore me kapacitet 3 MW, ngastra katastrale 1959-9 dhe 1959-15 ZK Lladroc, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Malishevës.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 4588 dt. 01.04.2026 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Parakontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar,
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.